

Sherr për pronën në Kavajë/ Xhaxhai kanos nipin me armë, arrestohet nga policia

0 KOMENTE November 30, 2022

Policia e Kavajës ka vënë në pranga një shtetas pasi kishte kanosur me armë nipin e tij.

Konflikti midis xhaxhait dhe nipit kishte nisur për motive pronësie.

Pas arrestimit, 57-vjeçarit I është gjetur në banesë armë zjarri automatik dhe municion luftarak.

Kavajë/Finalizohet nga Komisariati i Policisë Kavajë, operacioni policor i koduar "Property".
Vihet në pranga 1 shtetas që kanosi nipin e tij, për motive pronësie.
Sekuestrohen një armë zjarri automatik dhe municion luftarak, që u gjetën në banesën e të arrestuarit.
Shërbimet e Komisariatit të Policisë Kavajë, pas marrjes së kallëzimit nga shtetasi A. S., 30 vjeç, se xhaxhai i tij e kishte kanosur se do ta vriste, për motive pronësie, menjëherë kanë organizuar punën dhe kanë finalizuar operacionin policor të koduar "Property", në kuadër të të cilit u bë kapja dhe arrestimi i shtetasit:
– I. S., 57 vjeç, banues në Kavajë.
57-vjeçari ka kanosur për jetën nipin e tij, shtetasin A. S., 30 vjeç, për motive pronësie. Gjatë kontrollit të banesës së 57-vjeçarit, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri automatik, dy krehra dhe municion luftarak.
Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Posted Under: Kronike Kryesoret Vendi

Tagged: Kavaje Prona Sherr

Leave a Reply

Your email address will not be published. Required fields are marked *

Comment *

Name *

Email *

Website

Save my name, email, and website in this browser for the next time I comment.

Post Comment

SUBSCRIBE VIZION PLUS TV YouTube

ME TË LEXUARAT

Ja cilat janë femrat që kanë nevojë urgj...

Kërkesa për vendosjen e forcave serbe në...

"Mjaft është mjaft"/ Kryeministri britan...

Bashkëpunoi me djalin dhe një person tje...

Vritet 49 vjeçari në lokal/ U qëllua me...

TË TJERA NGA KRONIKE

Era e fortë dëmton serat/ Roskovec, fermerët thonë se stuhia u ka shkatërruar çdo gjë
më shumë...

Vrasja e biznesmenit në Tiranë/ Autori kishte të dhëna të plota mbi lëvizjet e 49-vjeçarit
më shumë...

Pse ra monedha europiane? "KESH-i ndërpreu importet, ka prurje të mëdha edhe nga emigrantët"
më shumë...

Sot, finalja e Kupës së Botës/ Argjentina dhe Franca përballen për trofeun e madh
më shumë...

TË TJERA NGA

Kroacia e treta në Botëror/ Fiton ndaj Marokut 2 me 1
më shumë...

Sot "finalja e vogël" e Botërorit/ Kroacia dhe Maroku duan ta mbyllin me sukses
më shumë...

Ndahet nga jeta Sinisha Mihajlovic
më shumë...

Të dielë finalja Argjentinë-Francë/ Masha tregon skuadrën: Ja kush dua ta fitojë Kupën e Botës
më shumë...

© VIZION PLUS TV ALBANIA 1999 - 2022
NDALOHET RIPRODHIMI I PAAUTORIZUAR I PERMBAJTJES SE KESAJ FAQEJE.